



Diana Mile: Bashkë për Pogradecin në drejtimin e duhur!

Çdo kandidat për kryetar bashkie në mënyrën më normale, mund t'ju kërkonte vota për fitoren e tij në Mokër, ndërsa unë **Diana Mile**, kandidatja e koalicionit të majtë për **Bashkinë Pogradec**, kam një detyrim më tepër për të realizuar kërkesat tuaja. Edhe pse jam lindur dhe rritur në qytetin e Pogradecit konfirmoj se në origjinën time rrjedh edhe gjak mokrari. Gjyshja ime nga babai, është vajzë nga dera e fisit **Shyta**, të cilët kanë jetuar në **Pleshisht**, të Mokrës së sipërme. I pari i tyre ka qenë kapedani me emër në të gjithë Mokrën, **Naum Ruho**.

Mbiemri Ruho, u ndryshua në **Shyta**, kur **Porta e Lartë** këkonte kokën e tij, pasi njihej si mbështetës i **Ali Pash Tepelenës**. E kapin me dredhi dhe ia presin kokën, njëllon si mikut të tij besnik **Ali Pashait**, myslimanit të famshëm të **Janinës**. Shumë njerës këtë histori nuk e besuan, disa e quajtën legjendë, por pjesa më e madhe e dinë këtë histori reale të treguar brez pas brezi në Mokër. Këtë fakt e dëshmon edhe një ditë pazari, që edhe sot e kësaj dite ekziston në **Dvor**, afër **Pleshishishtit**, ditë pazari kjo e caktuar nga **Ali Pashai**, për nder të **Naum Ruhos**.

Madje në këtë zonë ekziston edhe një këngë që këndohet për trimëritë e **Naum Ruhos**. Pasi i prenë kokën **Naum Ruhon** e quajtën në Mokër, "njeriu që eci me kokë të prerë". Trupi i tij dha shpirt me zor dhe tregohe
 (faqe 4)

Edhe folklori i Mokrës në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës 2015

Edhe Mokra kishte perfaqesuesit e saj te denje ne Festivalin Folklorik te Gjirokastrës, si pjese e Qarku te Korçës. Nje pjese e mire e ketij programi ishin nga folklori i pasur mokrar. Me kenget dhe vallet qe keta burra e gra mokrare percolen, terhoqen vemendjen e publikut por dhe te shume studjusve te pranishem. Avniu, Hetemi, Tekiu dhe te tjere jane ata burra mokrare qe jo vetem i njohin i kercejne e kendojne por dhe ia trasmetojne keto vlera te rralla publikut dhe brezave me te rinj. Mokra eshte thesar per nga vlerat folklorike dhe jo vetem te cilat nese ne te gjithë do t'i ruajme, ato do tronditin edhe skena me te medha siç dhe ka ndodhur. Vepra juaj te nderuar miqte e mi eshte nje gur ne



themelin e ndertesës se ketyre vlerave qe brezat do tua dine per nder. Urime!
G. BEGO



Lavdërim Miminllari,
 kandidati për anëtar i
 Këshillit Bashkiak të KZAZ
 nr. 67, Bashkia Pogradec
**VIZIONI E MISIONI IM:
 PËRVOJË DHE DREJTËSI
 AMERIKANE...**



DY ZONJAT ME VOTAT MOKRARE

Nga Ramadan KLLLOGJRI

Me Kandidatin e Partise se Unitetit Kombetar per Pogradecin, Koço Piqoni
**"VIZION, PUNË,
 UNITET, OPTIMIZËM"**



Istref Haxhillari zgjidhet kryetar i ri i shoqatës "Pelioni"

Thirrje e kryetarit drejtuar anetareve dhe simpatizanteve te shoqates

Takim festiv me rastin e daljes së numrit 200-të, të gazetës "Mokra"

Istref Haxhillari zgjidhet kryetar

Nga Zenun FERRO
Sekretari "Shoqatës"

Më date 9 maj 2015, me rastin e daljes së numrit 200-të gazetës "Mokra" 2015, në Tiranë u zhvillua një takim festiv me anetaret e shoqatës, redaksinë dhe bashkëpunetoret e saj.

Falenderoj pjesëmarrësit, nismëtarët e themelimit të gazetës dhe gjithë dashamirësit të cilët arritën deri në këtë numër 200. Vlerësoj secilin për atë që ka bërë dhe duhet të bëjë më shumë në gazetë, për vlerat dhe historitë të cilat duhen zbuluar, evidentuar e shkruar për të ardhmen se kështu i'a lëmë brezave tanë të shkruar. Uroj të gjithë juve dhe ata që janë atje në zonën e Mokrës dhe Pogradecit.

Gazeta kërkon punë dhe mbështetje dhe këtë do ta bëjmë ne të gjithë.

Flori SLATINA: Kryeredaktor i gazetës, me pak fjalë dhe me shumë vështirësi kemi arritur të vijmë deri këtu te ky numër gazete. Ju falenderoj të gjithëve nga fillimi në vitin 1999. Kjo nuk është arritur vetëm por ne të gjithë së bashku do të vazhdojmë të ecim pa lëkundje dhe të evidentojmë vlerat e Mokrës dhe Pogradecit. Në këto vite së bashku kemi arritur të shkruajmë diçka nga historia e vjetër e zonës tonë. Ju falenderoj të gjithëve.

Haki BALLIU: Vlerëson takimin dhe arritjen e numrit 200 të gazetës "Mokra". E nisëm me dëshirë të madhe dhe arritëm këtu jemi sot. Kemi bërë shumë, dua të ecim akoma të gjithë sidomos nga zona e Mokrës. Flanderon Florin si një vazhdues e i denjë i kësaj gazete dhe stafin e gazetës "Mokra"

Pëllumb ZADE: Si fillim dua të pergezoj e te uroj gazetën tone "Mokra" per suksesin e arritur, si dhe stafin redaktus te saj me ne krye Z. Flori, qe megjithe vesh-tiresite e shumta financiare, duke pasur edhe mbeshtetjen e vazh-dushme te kryesise te shoqates, ka mundur te permbushe me sukses objektivat e saj, per evidentimin e pasqyrimin real te traditave te shkelqyera mokrare, si dhe vep-rintarine e shoqates tone "PE-LIONI", duke mos munguar ne asnje numur te saj, duke arritur ne nr. Simbolik 200.

Te dashur antare te keshillit drejtus e te shoqates, ju falenderoj per sakrificat tuaja per te mos munguar ne kete takim. Periudha per te cilen po diskutojme 2009 deri 2015, mund te pranojme se eshte nje periudhe pune e pa nderprere ku ka zoteruar vazhdimesia e viteve paraardhese duke e cuar me perpara nxjerrjen ne drite te vlerave te shumta qe ka populli dhe krahina e Mokrës. Kryesia e re, e dale nga zgjedhjet e 8 majit 2009, iu vu menjehere punes duke u mbledhur cdo jave per t'u sugjeruar me shoket, e duke dale me perfundime e vendime unanime, ka gjetur celesin e mbarevajtjes



Kryesia e shoqates

ZGJEDHJET E REJA NË SHOQATËN "PELIONI"

Më datën 9 maj 2015 u zhvilluan zgjedhjet e reja të shoqatës "Pelioni". Nga zhvillimi i zgjedhjeve u zhdhohën organet e reja drejtuese si më poshtë:

Kryetar Istref Haxhillari
Sekretar Zenun Fero
Nënkryetar Zabit Cuku
Nënkryetar Bedri Mokrëri

6 Maliq Torra
7 Guri Bego
8 Pëllumb Zade
9 Istref Haxhillari

KRYESIA E SHOQATËS:

1 Haki Balliu
2 Flori Slatina
3 Zenun Fero
4 Bedri Mokrëri
5 Zabit Cuku

KËSHILLI DREJTUES:

1. Istref Haxhillari
2. Haki Balliu
3. Njazi Spahi
4. Flori Slatina

5. Zenun Fero
6. Xhevahir Shtupa
7. Bedri Mokrëri
8. Ramadan Klllogjëri
9. Zabit Cuku
10. Maliq Torra
11. Koço Pihoni
12. Guri Bego
13. Ariz Durbaku
14. Pëllumb Zade
15. Fuat Fero

te punes, ku gjithcka eshte evidentuar edhe ne faqet e gazetës tone. Si perparesi ne punen tone, ju dha zgjerimit e ristrukturimit te shoqates. Keshtu, nen kujdesin e vecante te n/kryetarit te shoqates Z. Istref Haxhillari, u zhvillua nje mbledhje e gjere me prezencen e shume antareve te rinj ne degen e Pogradecit ku u zgjodh kryesia e re e deges si dhe u ndane detyra e objektiva per secilin, sidomos per mbeshtetjen e tyre ne sistemimin e shperndarjen e gazetës ne baze fshatresh e lagjesh. Z. Niaz Spahiu, me te marre detyren e sekretarit te deges, punoj ne menyre shembullore duke vazhduar te shtojte radhet e shoqates, e per here te pare u realizua nje abonim vjetor me mbi 40 abonente, e kjo sigurisht esh-



te nje arritje jo e vogel. Po ne kete kuader, arritem te krijojme degen e shoqates ne kombinat, ku nje ndihme konkrete ka

dhene Z. Hariz Durbaku, qe aktualisht e mbulon kete degë. Me qellim qe shoqata te jete sa me serioze e ligjore, I pajisem te gjithe antaret me dokumentin e antaresise me foton perkatese per secilin. Ajo qe eshte me e rendesishme, kemi stimuluar e perkrahur inteligjencen mokrare sidomos krijuesit e rinj te saj, duke marre pjese vazhdimisht ne promovimet e reja te tyre jo vetem ne Tirane, por edhe ne Pogradec, Durres apo ne komunat Velcan, Trebinje e Proptisht, si dhe eventimente te tjera si keto. Kemi organizuar e ndjekur ngjarje te rendesishme kombetare ku me e spikatur ka qene festimi me dinjitet i 100 vjetorit te pamvaresise te atdheut, si dhe 70-vjetori i çlirimit ne Pogradec, ku

numuri me tre shifra i pjesmarresve mokrare, tregoj shkallen shembullore te organizimit nga kryesia, e sidomos nga dega e zones. Ne keto takime e te tjera te ngjashme, kemi ndare nje nr. te konsiderushem certifikatash mirenjohje per figura te dalluara te shoqerise ,qe po te kemi parasysh anen e dobet financjare qe kemi, ka qene nje kosto jo e vogel. Pa dyshim, me vlera ka qene e mbetet mbeshtetja qe kemi dhene e japim per bujqit, puntoret apo nxenesit e shkollave, pra elementin e thjeshte mokrar qe nepermjet takimeve direkte apo faqeve te gazetës i kemi nxitur per te qene sa me active ne jeten e tyre, te aktivizohen me shkrime te ndryshme poetike apo mbi jeten e perditeshme, hallet e problemet aktuale etj., e rezultatet nuk kane munguar. Kemi bere vizite kolektive ne varrezat historike te Selces etj. Edhe se jemi shoqate apolitike, ne kemi mbeshtetur me shkrime e intervista jo vetem te zgjedhurit vendore, por edhe ata politike si deputetet e rrethit pa bere asnje dallim se kujt force politike i perkasin, e kjo eshte nje merite e vecante e shoqates e gazetës mokra. Sigurisht qe puna e shoqates eshte shume me e madhe se kaq , ka shume antare apo simpatizante qe me shkrimet apo mendimet e tyre na kane ndihmuar shume duke dhene nje kontribut te madh ne mbarevajtjen e punes, ku mund te permend Z. Guri Bego, Bedri Mokrëri e shume te tjere, por une nuk jam zgjatur shume me emra te vecante.

Si konkluzion, mendoj, se kryesia ne pergjithesi eshte angazhuar maksimalisht per te realizuar detyrat e vena nga antaresia e saj, e mbeshtetur plotesisht ne statusin e shoqates si dhe e pasqyruar nepermjet organit te saj, gazetës Mokra. Megjithate, desha te ndalem edhe ne dicka qe e quaj te pa plotesuar. Edhe se beme mjaft perpjekje , ne pamundesi per te gjetur guhen e perbashket me nje ish kryetar i shoqates " mokra", menduam qe nepermjet gjukates te vendosnim nje emer tjetër per shoqaten te perafert me ate te gazetës, por kjo mbeti e pa realizuar, me pergjigje se "Duhet te ndryshohet me vendim ne mbledhjen e pergjitheshme" prandaj une mendoj qe sot ta diskutojme e te marrim nje vendim e te ndiqet nga kryesia e re qe do zgjidhet. Nje tjetër pike te pa plotesuar konsideroj faktin se ne si shoqate qe deshirojme e perpiqemi per mokren, jemi ne opozite me cdo qeverri qe ka pushtetin, e majte apo e djathte qofte, qe do te thote se vazhdimisht duhet te kerkojme prej tyre jo vetem me elozhe e lavderime por edhe me kritika te ashpra nje angazhim me te madh per te financuar apo ndihmuar ate zone, qe realisht eshte me e varfere e vendit ndersa interesimi nga te gjitha qeverrit ka qene zero, se ne te kundert do na konsiderojne si nje grup qe lavderojme e servilosemi, duke sherbyer vetem per te fshire pluhurin e xha-

i shoqatës “Pelioni”



Profil

I martua me tre fëmijë.

Përndryshe zoti Haxhillari është shkrimtar, ka botuar tetë libra në gjuhën e prozës, romane, novela dhe tregime. Një pjesë të krijimit të tij letrarë e ka përcjellë edhe gazeta “Mokra”. Më 23 prill 2010, në ditën botërore të librit, ambasada e Spanjës në Shqipëri e përzgjedhi për çmimin “Don Kishoti”.

Zoti Haxhillari është bashkëpunëtor aktiv i gazetës dhe veprimtar i shquar i Shoqatës mokrare “Pelioni”. Deri tani ka qenë nënkryetar. Në aktivitetin e zgjeruar të datës 9 maj të këtij viti u zgjodh njëzëri kryetar.

Në emër të lexuesve, gazeta “Mokra” i uron zotit Istref Haxhillari detyrën dhe shpreh besimin se nën drejtimin e tij Shoqata jonë do të njohë arritje të reja.

Redaksia e gazetës

THIRRJE

Të dashur miq,

Kam kënaqësinë t’u informoj se në numrin e saj të 200-të, gazeta “Mokra”, organ i Shoqatës mokrare “Pelioni”, e gjen veten në shumë mjedise ku jetojnë sot mokrarrët. Përmes internetit gazeta është bërë pronë e mijëra lexuesve të shpërndarë nëpër botë, mokrarrë dhe miq që Krahina jonë i mësoi të hedhin hapat e parë në jetë si agronomë, veterinerë, mësues, mjekë.

Gazetarë të “Mokrës” u bënë shumë dhe sot nuk mund t’i numërosh të gjithë. Përreth saj po grumbullohen gjithnjë e më shumë pena, deri dje në heshtje, po ngacmohen gjithnjë e më shumë burra e gra që e duan vendin e tyre, që i zë malli për ato troje të lashta dhe hedhin në letër ndjenja të holla.

Përsëritës të gjithë ata që ushqejnë me shkrime nga më të ndryshmet “Mokrën” tonë, këtë perëndeshë që sot mbushi pesëmbëdhjetë vjet.

Ajo që na bashkon ne, mokrarrëve, kudo ku jetojmë e punojmë është gjeni i vendlindjes, shpirti i të parëve që bënë historinë mokrare dhe krijuan eposin e vendit tonë, të pangjashëm me asnjë tjetër. Është detyra e të gjithëve të mos e lëmë të harrohet tradita, të mos harrohet historia, të mos harrohen varret e të parëve, struktur përjetësisht në gjirin e dheut mokrarr.

Kryesia e Shoqatës në takimin e fundit zgjedhor vendosi të krijohen strukturat në të gjitha qytetet dhe fshatrat ku banojnë mokrarrët e larguar nga vendlindja për jetë më të mirë. U bëj thirrje të gjithëve të mbliidhen e të krijojnë degë të Shoqatës në vendet ku ende nuk janë krijuar si Elbasan, Durrës, Lushnjë, Përrenjë, Korçë etj. Nismëtar mund të bëhet kushdo që i dhimbset vendi i tij për të grumbulluar bashkëkrahinasit. Kryesia është e gatshme të mbështesë çdo nismë, të dërgojë përfaqësuesit e saj për të ndihmuar në krijimin e strukturave për ta bërë Shoqatën e mokrarrëve prezente në të gjitha vendin e më gjerë.

Ju uroj të gjithëve shëndet, gëzim e lumturi në familjet tuaja.

Istref Haxhillari, kryetar

ketave të pushtetareve. Sigurisht, te jesh kritik ndaj njerezve me pushtet nuk është e lehtë se ka edhe nga shoket e tu të lidhur me pushtetin, e nuk do mungojnë hatërmbetjet apo mos aprovimet, por e konsideroj një detyrë morale një sacrifice të tillë për njerezit e varfer. Jam i ndergjegjshëm se ata për të cilët po flas, nuk kanë shans të degjojnë apo lexojnë keto që them une, sepse dikush ruan bagetinë, dikush leron token duke mbrehur gomarin apo lopen në parmende apo duke e terhequr vete, dikujt i ka mbetur rruga e emigracionit etj., por flas për ata që kanë mundësi dhe inteligjencën, që flasin e shkruajnë se duhet një obligim me i madh për ata fshatare të varfer mokrare se askush nuk i perfll, se ka 10 vjet që flitet vetem në prag fushatash për rrugën famemadhe të mokrës, që gjenden edhe fondet, por me mbrapa nuk dihet se nga shkojnë. Personalisht, keto probleme e të tjera si keto do i ngrë në cdo pozicion e kohe që do me jepet mundësia pamvaresisht se kush është në pushtet. Ndofta askush nuk do e degjojë kete zë, por une do jem i qete në ndergjegjshëm time, se bera aq sa munda.

Istref HAXHILLARI: Unë u jam mirënjohës të gjithëve dhe shpreh falenderimet për arritjen e kësaj date. Të ecim sa më shumë të gjithë të shtojmë forcat dhe punën për të ardhmen. Kam shkruar shumë libra për trevën e Mokrës. Falenderoj miqtë e mi Hakiun, Florin, Zenunin, Pëllumbin, Zabitin, Danen dhe gjithë mbështetësit e mi në Pogradec.

Zabit CUKU: Nënkryetar i shoqatës “Pelioni”. Kemi shkruar dhe kemi folur për disa vite në këtë gazetë mokrare. Tani u mësuam dhe u gëzofshim të gjithë me këtë arritje të numrit 200 të zetas “Mokra”. Nuk ka qenë e lehtë kjo punë dhe tani ka më shumë vështirsi por dëshira e mirë nuk të pengon dhe të hap rrugë për të ecur. Prej disa vitesh jemi angazhur me këto aktivitete në Tiranë, në Mokër, në Rrajcë, në Pogradec dhe, ku ka mokrarrë. Të gjithëve ju uroj dhe vlerësoj punën e Haki Balliut, Florit, Samiut, të Zenunit, të mikut tim të vjetër që nga marsi vitit 2008 Istrefin. I cili ka vlera dhe ka një tregues shumë të ngjeshur me shoqatën dhe gazetën. Njazin i cili po jep vërtetë vlera në degën e Pogradecit, Danen me Arizin dhe Hiqmetin të cilet janë në çdo kohë në aktivitet dhe me atë ngrohtësinë e tyre vërtetë dua ti falenderoj. Më shumë duhet përpahja në thellësi të krahinës dhe lidhjet me pushtetin vendor me vepra konkrete e jo të përgjithshme. Urime dhe suksese më të mira mos u tërhiqni se më mirë do të bëhet në të ardhmen.

Më pas e morën fjalën edhe anëtarë të tjerë. Takimi kaloi në një atmosferë festive, ku u zgjodhën edhe organet drejtuese të shoqatës, që do ta drejtojnë shoqatën për 5 vjetet e ardhshme, 2015-2020.



Përkujtohet 72-vjetori i krijimit të Çetës së Mokrës

Ditën e diel më 17 maj u shënua në fshatin Pleshisht përvjetori i 72-të i krijimit të Çetës së Mokrës që më pas u quajt batalioni “Reshit Çollaku”, organizuar nga Komiteti i Veteranëve të rrethit dhe Komuna Trebinjë. Me këtë rast u mblodhën disa qindra banorë të Mokrës së Sipërme dhe të tjerë, ardhur nga qyteti i Pogradecit dhe komunave e Mokrës.

Ishte e pranishme zonja Diana Mile, kandidatë e Aleancës qeveritare për bashkinë e Pogradecit në zgjedhjet e pritshme lokale. Në fjalën e hapjes, kryetari i komunës Trebinjë, Feim Jasharllari pasi kujtoj ngjarjen e lavdishme të majit 1943, u kërkoi banorëve të mbështesin kandidaturën e zonjës Diana Mile. Sekretari i Komitetit të veteranëve, Livan Fezollari foli për formimin e Çetës së Mokrës, partizanët dhe dëshmorët mokrarrë të rënë në luftën për liri. Në takim foli edhe zoti Roshi Tollozhina, kryetar i LSI së rrethit, i cili u kërkoi banorëve të mbështesin kandidaturën e propozuar nga kjo forcë politike në zgjedhjet lokale për të vazhduar projektet e nisura më herët në katër vitet e shkuara. Zoti Bedri Mokrevi, anëtar i Komitetit Kombëtar të Veteranëve dhe nënkryetar i Komitetit të Veteranëve të rrethit ndau disa dokumente anëtarësimi për pasardhësit e veteranëve të kësaj zone.

Më poshtë po japim të plotë fjalën e kryetarit të Shoqatës mokrare “Pelioni” mbajtur në këtë takim.

Koresp. i gazetës “Mokra”.

Epopeja e Pleshishtit

Të dashur miq,

Në historinë e çdo vendi ka ngjarje me përmasa të mëdha, të cilat nga pikëpamja e rolit që kanë luajtur në jetën e banorëve të tij, përbëjnë kulme të historisë. Formimi i çetës së Mokrës nga Reshit Çollaku dhe shokët e tij në 17 majin e vitit 1942, pa dyshim shënon një kulm në përpjekjet mokrare dhe më gjerë për liri e pavarësi si pjesë përbërëse e luftës për të drejta kombëtare dhe emancipim shoqëror.

Kjo ditë është një gur i çmuar në gjerdanin e lavdisë për të gjithë rrethin e Pogradecit.

Çeta e Mokrës është ndër të parat formacione partizane të ngritura në vendin tonë krahas asaj të Pezës, Çetës plakë Mallakastrës, Çetës së Martaneshit etj. Në këtë vend ku jemi mbledhur sot u erdhën të parët tanë nga të gjithë fshatrat rreth e rrotull për të lidhur besën në luftë pa kompromis kundër okupatorit. Shumë shpejt Çeta e Mokrës do ta afirmonte me zjarr e gjak angazhimin e vet patriotik. Janë të shumta betejat, siç u përmendën këtu, për të arritur të legjenda e Pojskës e deri në çlirimin e vendit.

Atëherë nuk luftohej për grada e ofiqe, as privilegje ekonomike e sociale.

Lufta botërore ishte përplasje gjigande njerëzish dhe armatimesh nga më modernet e kohës, me miliona viktime dhe shkatërrime të pashembullta në historinë e planetit. Shqipëria e vogël mbajti të gozhuara forca të konsiderueshme të Boshtit luftënxitës në një betejë për jetë e vdekje,

duke i detyruar ata të tërhiqen me turp nga të gjitha viset arbërore, dha 28.000 dëshmorë dhe e fitoi lirinë me gjak e sakrificë të panumërta. Lufta nacional-çlirimtare është epopeja më e madhe historike e popullit shqiptar.

Në asnjë rast të mëparshëm apo të mëvonshëm nuk ka shkëlqyer guximi, trimëria dhe vendosmëria e shqiptarëve për të larguar pushtuesit nga trojet e veta.

Sa herë vjen maji, ne, mokrarrët, kujtojmë me respekt besëlidhjen e Pleshishtit, historinë, gjakun e të parëve, heroizmin dhe trimërinë, bëmat e panumërta përgjatë kohës së shkuar. Kur vjen maji duket sikur festojmë një ditëlindje të madhe që nuk harrojmë kurrë ta kujtojnë, pa çka se jo gjithnjë në një mendje me njëri tjetrin.

Miq të e mi,

Ajo që na bashkon ne, mokrarrëve, kudo ku jetojmë e punojmë është gjeni i vendlindjes, shpirti i të parëve që bënë historinë mokrare dhe krijuan eposin e vendit tonë, të pangjashëm me asnjë tjetër. Është detyra e të gjithëve të mos e lëmë të harrohet tradita, të mos harrohet historia, të mos harrohen varret e të parëve, struktur përjetësisht në gjirin e dheut mokrarr.

Më lejoni t’u përsëritës në emrin e Shoqatës “Mokra” e cila ka marrë mbi vete misionin e evidentimit dhe përcjelljes së vlerave mokrare, brezave që do të vinë, duke përfshirë edhe këtë ngjarje madhore.

Faleminderit.

Istref HAXHILLARI
Kryetar i shoqatës mokrare
“Pelioni”

DIANA MILE: Bashkë për Pogradecin në drejtimin e duhur!

Cdo kandidat për kryetar bashkie në mënyrën më normale, mund t'ju kërkonte vota për fitoren e tij në Mokër, ndërsa unë **Diana Mile**, kandidatja e koalicionit të majtë për **Bashkinë Pogradec**, kam një detyrim më tepër për të realizuar kërkesat tuaja. Edhe pse jam lindur dhe rritur në qytetin e Pogradecit konfirmoj se në origjinën time rrjedh edhe gjak mokrari. Gjyshja ime nga babai, është vajzë nga dera e fisit **Shyta**, të cilët kanë jetuar në **Pleshisht**, të Mokrës së sipërme. I pari i tyre ka qenë kapedani me emër në të gjithë Mokrën, **Naum Ruho**.

Mbiemri Ruho, u ndryshua në **Shyta**, kur Porta e Lartë këkonte kokën e tij, pasi njihet si mbështetës i Ali Pash Tepelenës. E kapin me dredhi dhe ia presin kokën, njëllon si mikut të tij besnik Ali Pashait, myslimanit të famshëm të Janinës. Shumë njerës këtë histori nuk e besuan, disa e quajtën legjendë, por pjesa më e madhe e dinë këtë histori reale të treguar brez pas brezi në Mokër. Kët fakt e dëshmon edhe një ditë pazari, që edhe sot e kësaj dite ekziston në Dvor, afër Pleshishshit, ditë pazari kjo e caktuar nga Ali Pashai, për nder të Naum Ruhos. Madje në këtë zonë ekziston edhe një këngë që këndohet për trimëritë e Naum Ruhos.

Pasi i prenë kokën Naum Ruhon e quajtën në Mokër, "njeriu që eci me kokë të prerë". Trupi i tij dha shpirt me zor dhe tregohet se realisht eci rreth 10 metër me kokë të prerë. Më pas Naumin e quajtën **Shyta**, një sinonim ky i njeriut që ecën me kokë të prerë...

Ruhot e Pleshishtit për t'i shpëtuar ndëshkimit të Portës së Lartë, shpërngulen nga Mokra dhe vendosen në fshatin Tushemisht të Pogradecit. Ata nofken **Shyta** e bënë mbiemrin e tyre të ardhshëm. Ky fis u shtua dhe u gëzua duke mos e mbyllur derën e të parit të tyre, kapedanit trim të Mokrës, Naum Ruhos, emri i të cilit e ka kaluar kufirin e legjendës prej fakteve historike.

Gjyshi im nga babai është bir nga **fisi Mile** në Pogradec. Ne profesionin e tij të nderuar të kovaçit, ai fliste artistikisht me hekurin dhe i jepte atij jetë. Prindërit e mi, babai im i ndjerë dhe i nderuar profesori i fizikës Thomai, mama-ja ime mësuese e ciklit fillor



Marjana, bijë e kasapit që e nohin të gjithë në rrethinat e Pogradecit me emrin Xhyra, do të përcillin tek unë dashurinë për Pogradecin. Unë jam 100% pogradecare dhe përfaqësoj brezin e shtatë të Milellarëve në të njëjtën kalldrëm...

Pra, vij nga një familje e vjetër e qytetit, ku të parët e mi



ishin pjesë e njerëzve të urtë, të mençur dhe mikpritës të këtij vendi.

Jam shkolluar në Universitetin e Tiranës për Arkitekturë dhe e dua shumë profesionin tim si arkitekte. Pogradecin e mendoj ashtu si ato projektet e skicuara në letër dhe mezi pres ta realizoj dhe ta finalizoj bukur si një vepër arkitektonike. Ajo që dua t'i jap unë Pogradecit është aktualja... Të ruajmë atë çka na ka falur natyra dhe atë që të parët kanë ndërtuar me mund e djersë, por edhe t'i shtojmë ato që duan të shikojnë të rinjtë e sotëm. E thënë thjesht: "Koha për Pogradecin" dhe dua që të jem projektuese e kësaj motoje.

Nuk dua të dukem aspak naive në pohimet e mia, por e vërteta është së zëri i të parëve të m'i më therrët këtyre anëve plot histori dhe mikëpritje shqiptari. Është koha të kthejmë sytë të gjithë nga Mokra e harruar e pushtetarëve që rrëmbejnë vota dhe ikin. Është koha për investime serioze për Pleshishtin e fisit tim dhe gjithë Mokrën në tërsinë e saj. Vota juaj për një arkitekte është vota e rilindjes së kësaj zone të harruar në 25 vjet demokraci. Votoni bijën tuaj më 21 qershor, në emër të një amaneti të të parëve tuaj, në emër të ndryshimit që do sjellë investime në këtë zonë që dikur kishte shkëlqim e bujari, e që sot ka mbetur e shkretë dhe e braktisur...

Programi im për transformimin dhe ndërtimin plot investime të zonës së Mokrës, është rruga që duhet të mbështesni më 21 qershor! **Kërkesat tuaja pas 21 qershorit do të bëhen Realitet!**

Bashë do të krijojmë më shumë mundësi punësimi për mokraret, por edhe më shumë tërheqje për turistët. Shumë impenjim do të ketë bashkia në fushën e bujqësisë dhe pemëtarisë. Ky dimension i ri administrativ do të sjellë më shumë punë dhe para për zonë e Mokrës. Veçanërisht do të bëhet kultivimi dhe përpunimi i qershisë. Ndërsa një nga shtëpitë karakteristike të Proptishtit do të shndërohet në muzeun entongarfik më interesant të zonës dhe gjithë Shqipërisë...

Të gjithë bashkë ju ftoj të më votoni më 21 qershor, mua Diana Milen! Të gjithë bashkë pas kësaj date do të vijojnë të ecim më të realizuar në drejtimin e duhur!

Vizioni dhe misioni im: Përvojë dhe Drejtësi Amerikane...

Lavdërim Miminllari, kandidati për anëtar i Këshillit Bashkiak të KZAZ nr. 67, Qarku Korçë, Bashkia Pogradec

Ndryshe nga shumë zgjedhje të tjera, por edhe nga praktikat e ndjekura të forcave politike, që hartojnë lista kandidatësh për të gjitha nivelet dhe ato mbeten të mbyllura për publikun në të shumtën e rasteve, kësaj radhe tentohet një formë e re. Kandidati për anëtar në Këshillin Bashkiak Lavdërim Miminllari tenton të veprojë krejt ndryshe, duke menduar se i vihet në ndihmë votuesit, pa dallim dhe i lind e drejta për t'i kërkuar votën në zgjedhjet e 21 qershorit 2015, duke paraqitur dhe platformën e tij si këshilltar.

Neve na u duk me interes e kontaktuam dhe realizuam këtë intervistë:

-Zoti Miminllari! Ju jeni i pari, që po prezantoni një vizion të ri në këto zgjedhje, po kandidoni për t'u bërë pjesë e një strukture, siç është, Këshilli Bashkiak, që do të dalë nga zgjedhjet e 21 qershorit 2015. Cilët janë motivet, që iu shtynë për këtë nismë?

“Motivi, që më nxiti për të marrë këtë nismë për të qenë anëtar i Këshillit Bashkiak, së pari do të radhis ndërgjegjen time të pastër, ndershmëria për t'u shërbyer qytetarëve me përkushtim kudo qofshin në fshat apo qytet. Besoj në aftësitë e mia për të prezantuar të gjitha nevojat e komunitetit dhe të këmbëngul për zgjidhjen e tyre. Për mua fjala korrupsion nuk ekziston në jetën dhe përvojën time, do të jem barrikadë kudo e si do të shfaqet ai. Edhe tani jetoj me hallet dhe problemet e gjithë komunitetit të rrethit: Qytet, Mokra dhe zonat përreth qytetit, Hudënishti, Çërrava, Dardhasi, Buçimasi, por pas 21 qershorit 2015 dua të jem zëri i tyre, zgjidhja dhe mbështetja e tyre”.

-Çfarë ka në linja themelore forca Juaj politike, (Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve) që ju përfaqësoni, në këto zgjedhje?

CILI ËSHTË KANDIDATI LAVDËRIM MIMINLLARI?

Pasaportë elektorale

Është i datëlindjes 09.08.1956 në Blacë. Ka mbaruar Arsimin e Lartë: Menaxhim Biznesi. Ka emigruar dhe punuar për 12 vjet në Taylor Michigan SHBA. Ka punuar në Minierën e Qymyr-Gurit Alarup për 20 vjet. Është themelues dhe kryetar i Shoqatës Kulturoro-Historike “Mali i Thatë”. Ka përvojë në Shoqërinë Civile, përvojë Sindikaliste nga viti 1992. Flet dhe shkruan gjuhën Angleze.

“Forca jonë politike linjën kryesore ka Lëvizjen për Drejtësi. Ajo kërkon vetëm drejtësi për zgjidhjen e të gjithë problemeve, në luftë të hapur kundër korrupsionit, informalitetit, pandëshkueshmërisë, për të qenë të gjithë të barabartë para ligjit”.

-Sa dhe si i njihni problemet e të gjithë komunitetit dhe pse njerëzit duhet të votojnë për Ju?

“Problemet e komunitetit i njoh dhe jam në proces për të qenë më afër tyre për



isht deri në 10 % drejt nivelit zero. Me të njëjtin përkushtim do të punoj e mendoj edhe për zonat rurale, duke filluar nga infrastruktura dhe të gjitha shërbimet dhe shqetësimet për tokën, ujitjen, farërat, punimet, çështjet e pronësisë etj. Unë mendoj se elektorati duhet të votojë për mua për motivet e mia. Unë jam ndryshe nga të tjerët në vizionin tim dhe drejtësinë time Amerikane. Do të jem këmbëngulës në trajtimin e taksave dhe tarifave për komunitetin. Telefoni im do të jetë gjithëmonë i hapur. Jo vetëm telefoni, por edhe një faqe të hapur në internet, ku të pres shqetësimin qytetar”.

-Cila është përvoja Juaj, a jeni Ju person publik dhe si do të bëhi zëri dhe mbështetja reale e komunitetit?

“Në SHBA kam qenë anëtar në Shoqatën e Fëmijëve me të meta Mendore. Aktualisht drejtoj shoqatën Kulturoro-Historike “Mali i Thatë” me status “Person Juridik”. Jam përfaqësues i shoqatës së Biznesit të Vogël në Pogradec dhe zëvendëskryetar i kësaj shoqate me seli në Korçë. Administrtoj dhe menaxhoj një këmbim valuator. Kam qenë kontribues në Amerikë për librin “Shqiptarët e Amerikës”. Jam njeri i mendimit të lirë.

Së fundi më duhet të nënvizojë si një motiv më shumë porosinë e prindërve të mi, që më këshillonin: “Bir, çdo herë vëre veten në rolin e atij, që ka një hall dhe kërkon një zgjidhje, një ndihmë! Kjo moto më udhëheq edhe sot në jetë me mbështetjen edhe të familjes sime Eliverta dhe djalit tim Stiven dhe gjithë trugun tim familjar, miq edhe shokë të vërtetë.

Intervistoi: Dhimitër GEGPRIFTI

LETËR E HAPUR

Ndërtoni rrugën e Rrodokalit!

**DREJTUAR :-Deputetit te zones z.Illir Xhangolli
-Ministrit te trasportit z.Edmond Haxhinasto
Per dizeni: Kryetarit te PS, kryeministrit z.Edi Rama**

Ne qe po ju shkruajme jemi banoret e tre fshatrave ne zonen e Mokres, Rrodokal Siper, Rrodokal Poshte dhe Homezh. I njejti shqetësim eshte dhe per fshatin Katjel por qe nuk eshte ne zonen tone. Zgjedhjet po afrojne dhe ju te nderuar zoterinj po pergatiti te vini dhe te na kerkoni votat si gjithnje. Por meqe keni mese dy vjet qe nuk keni shkelur ne keto ane duam tu bejme te ditur disa shqetësimet tona qe kete here duhet te mendoji mire kur te vini dhe nga ana tjeter t'u njoftojme se vetem me xhipa shume te larte mund te arrini tek ne.

Zoterinj!

Kjo treve prej kater fshatrash me nje popullsi sot me rreth 5000 banore eshte aty qe ne shekujt e pare p.e.s. Eshte aty dhe ka luftuar per mbrojtjen e ketyre trojeve me romaket, sllavet, greket, serbet, bullgaret, turqit, fashistet, nazistet e deri me sot me armikun me te fuqishem qe eshte varferia. Kete popull nuk kane mundur ta asimilojne as shpata, as pushka, as torturat e as sistemet e ndryshme politike e ekonomike. Ai ka luftuar dhemb per dhemb me te keqen. Edhe pa buke, dhe i vrare e i prere, i syrgjynosur ne maxhirleket Bullgare e slave ai nuk e ka lene vendin e ti, token e Fismbretit e te Mokres. Ai eshte betuar qe ne kohen e Kapedan Argejvinit per “Dheun e Mokres”, per “Dheun e Fismbretit” dhe i qendron dhe sot e kesaj dite ketij betimi. Mbi kete pjese te vogel te tokes Arberore jeta eshte e hereshme, vendbanimet prejhistorike te Rrodokalit, Selces, Homezhit, Katjelit e tregojne kete. Kjo treve eshte e bekuar nga zoti ndaj dhe



njerëzit jane aty dhe nuk largohen pavarsisht nga politikat e kunderta qe behen. Ajo eshte e bekuar se eshte e pasur nen toke e mbi toke. Rezervat e shumta te hekurit ne Katjel e Rrodokal, ato te kromit ne Katjelice, Rrodokal e Homezh, te qymyrgurit ne Homezh e te tjera kane terhequr banoret qe ne antikitet e deri sot te banojne aty. Ato kane qene baza e zhvillimit prehistorik te ketyre fshatrave. Por nga ana tjeter keto rezerva kane shtuar dhe oreksin e parive e qeverive per t'i shfrytëzuar ato, mandej per ti grabitur ato dhe me ekeqja pa lene as nje gjurme investimi aty. Toka pjellore e punushme sot rreth 1000 ha, pyjet, ujrart natyrale, prodhimet bujqesore e blektorale, klima e ngrohte e te tjera jane resurse te pa zevendesushme per jeten e ketyre njerzve qe me pak ndihme mund te kthehen ne rezerva te medhe te ardhurash

per ta. Hekurin, kromin me nuanca te dukshme floriri, qymyrin e ketyre fshatrave njerzit kembezbathur, me kafshe dhe shpesh ne kurriz e kane nxjerre per te shitur qe ne ekzistencen e rruges “Egnatja”, ne kohen e Turkut, te Zogut e me mbrapa. Ne jemi deshmimtare qe shteti komunist i shfrytëzoi barbarisht keto burime. I kemi akoma ne vesh shqetësimin qe na krijonin borite e skodave te pa fund qe ngarkonin hekur, krom dhe qymyr. I gjithë Pogradeci e zona per rreth dyndeshin ne vjeshte ne dy Rrodokalet per specia, rrush e çdo gje tjeter aq sa as per vehte nuk u mbetej gje. Gjith prodhimet bujqesore, blektorale te ish kooperatives shkonin ne shtet. E çfare ka ngelur per keto fshatra? Asgje, pervec nje rruge te ngushte me gure qe sot eshte cope-cope. Edhe pas viteve nent-edhjetë e deri me sot vazhdon e njejta histori dhe me keq akoma. Te gjitha keto pasuri i rrembeu privati duke lene prapa shkaterrim e mjerim. Pra populli i kesaj zone kaq te pasur dhe sot mbas dymije vjet hecen kembe zbathur mbi hekurin, floririn e kromit, qymyrin e te tjera ne kerkim te mbijeteses. E sikur nuk na mjafton kjo por sefundmi, keta njezet vjet demokraci partite e qeverite e tyre jo vetem u bejne karshillek, por ne menyren me ekstreme tallen me ta. Per çdo fushate vine premtojne (genjejne) marrin votat e ikin. Kur u duhen prap kujtohen se ka ca njerez dhe ne keto fshatra dhe qe duhen gjenjer prap. Zoterinj me siguri qe do vini te inaguroni shkollen e pa perfunduar e te na i shisni per te disaten here si nje investim qe ju jep te drejten te krenohi. Nese e beni nuk eshte mire per ju. Paradoksi eshte se ky popull kerkon vetem nje mundesi, nje rruge per te punuar dhe vene ne eficence maksimale token e tij. Sa pak per nje qeveri te popullit. Ka gjashte a shtate vjet qe ka filluar puna per te shtruar rrugen qafa e zhgllapit (zhellarit) deri ne Rrodokal Siper. Gjatesia e saj eshte 8133.5 ml, sipas projektit te miratuar: Koha e fillimit te punimeve ne kete rruge eshte data 09.09.2009. Periudha e zbatimit te punimeve eshte 365 dit. Afati i perfundimit te ketij projekti eshte data 08.09.2010. Vlera e investimit eshte rreth nje miliard lek. (vijon ne faqen 7)



Edhe folklori i Mokrës në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës 2015

Edhe Mokra kishte perfaqesuesit e saj te denje ne Festivalin Folklorik të Gjirokastrës, si pjese e Qarku te Korçës. Nje pjese e mire e ketij programi ishin nga folklori i pasur mokrar. Me

kenget dhe vallet qe keta burra e gra mokrare percollen, terhoqen vemendjen e publikut por dhe te shume studjusve te pranishem. Avniu, Hetemi, Tekiu dhe te tjere jane ata burra mokrare qe jo vetem i

njohin i kercejne e kendojne por dhe ia trasmetojne keto vlera te rralla publikut dhe brezave me te rinj. Mokra eshte thesar per nga vlerat folklorike dhe jo vetem te cilat nese ne te gjithë do t'i ruajme, ato

do tronditin edhe skena me te medha siç dhe ka ndodhur. Vepra juaj te nderuar miqte e mi eshte nje gur ne themelin e nderateses se ketyre vlerave qe brezat do tua dine per nder. Urime!
G. BEGO

Rrajca dhe marrëdhëniet e saj me fshatrat për rreth

Nga Kujtim STOJNA

Rrajca, kjo trevë e lashtë e Ilirisë ka qenë e banuar që në ato kohë nga shqiptarët. Gjatë rrjedhës së historisë kjo trevë është përballur me shumë ushtri barbare që erdhën në këto anë nëpërmjet rrugës kryesore Egnatian dhe rrugën e karvanit në veri të Rrajcës. Përballja me ushtritë dhe taborët e Perandorisë Osmane janë të hershme që në kohën e dyndjeve drejt Ballkanit Perëndimor. Para se të dalë figura e heroit tonë Gjergj Kastriotit Skënderbeut, ndofta rreth vitit 1300 vit ku shqiptarët kanë bërë një betejë të përgjakshme me turqit në Fushë Kosovë. Por beteja që la gjurmë dhe ka hyrë në historinë e popullit tonë dhe trevës së Rrajcës është ajo e zhvilluar në fushën e Torviollit të asaj kohe, në Domosdovën e sotme në vendin e quajtur Karabatak pranë komunës (Rrajcë). Gjatë 25 vjetëve kjo trevë e mbajti me lavdi jehonën dhe fitoren mbi turqit. Ajo u mbrojti me vendosmëri nën udhëheqjen e Skënderbeut që shumë herë ai me trimat që mbante pas shfaqje shpesh në këtë trevë për t'u zënë pritë taborëve turk tregonin të parët se Skënderbeu pat ardhur në Fir të Gjinit dhe në Demjan. Një Guri aty në Skënderbeun e sotëm i thonë Guri i Gjergj Gjonit. Në kalanë prej Guri në Pishkash i themi sofa e Skënderbeut. Marrëdhëniet e Rrajcës me fshatrat Pishkash dhe Skrosk gjatë rrjedhës së jetës në këtë zonë. Me Pishkashin Rrajca ka pas marrëdhënie të mira miqësore me shumë fise të mëdha e me emër të dëgjuar. Fisi Allidri ka patur marrëdhënie me Istref Mekshin. Me Kamer Skurën fisi i Çukut me Skurën fisi e Stojnes me fisin e Bisku etj. marrëdhëniet u shtuan e u zhvilluan gjatë viteve të luftës për liri e pavarësi dhe në veçanti gjatë luftës kundër serbo-bullgarëve që na sulmuan gjatë viteve 1915. Viti 1913 ka qenë fatal për Shqipërinë dhe për trevën tonë. Fuqitë e mëdha vendosën copëtimin e trojeve etnike të shqiptarëve duke ua dhuruar si plaçkë lufte serbëve Kosovën, grekërve Çamërinë, malazezëve Ulqinin e trevat rreth tij sllavo-bullgarëve, Shkupin Manastirin Ohrin Strugë -Tetovë e Gostivar. Më 22 tetor 1913 Komisioni i caktimit të kufijve të Shqipërisë arriti në Rrajcë. Aty komi-

sioni ndërkombëtar donte që fshatin Lin t'ua jepte maqedonasve. Më 25 tetor vjen kryetari i komisionit Gjenerali Petapov. Fshati Lin u ngriti në protestë dhe kundërshtoi me forcë që kufiri të vendosej në Poterinë afër Ohrit. Mbas një vit konfliktesh patriotët e fshatrave për rreth lidhën besën dhe u grumbulluan 3000 vullnetarë luftëtarë nën komandën e Riza Hajro Ladorishti me këto forca u bashkua edhe çeta e Rrajcës e udhëhequr nga Hamit Allidri.

Na mungojnë dokumentet për luftëtarët e çetës së Rrajcës por sipas tregimeve gojore çdo fis në Rrajcë e çonte djalin e vet në çetë. Pishkash kishte Kamer Skurën Skrosku, Sali Omerin - Përrenjasi Maliq Kariqin, Kotodeshi nga i pari i fisit Hoxha etj.

Më 7 shkurt 1915 forcat e besëlidhjes sulmuan karakollët serbë i dogjën dhe e shtynë kufirin deri në Petrinë afër Ohrit. Kjo luftë i ngriti lart moralin e luftëtarëve dhe komandantit Riza Hajro iu këndua kënga këtij trimi që nuk ju tremb syri në luftë. Në Petrinë kush shkoi i pari Riza Hajro kapedani. (Vargjet e këngës). Më 25 shkurt 1915 forcat serbe të mbështetura nga austriakët sulmuan vullnetarët shqiptarë dhe i morën prapë pozicionet e para. Ato u futën në thellësi të trojeve tona duke e djegur e plaçkitur Rrajcën asnjë shtëpi nuk lanë pa djegur në Rrajcë duke i djegur të gjallë pleqtë që nuk mundën të largoheshin nga shtëpitë e tyre ato nuk kursyen as djemtë e pa rritur që kapën në rrugë kur tentonin të largoheshin. Në këtë shkatërrim barbar që ju bë Rrajcës mbetën të djegur Selman Halili, Latif Çuku dhe u masakruan Feim dhe Vehbi Rira, Bajram Alla. Në këtë kohë fshatrat për rreth Rrajcës e ndanë bukën e gojës me familjet e Rrajcës që u bë shkruar nga serbët, shumë fise fisnike dhe bujare strehuan në shtëpitë dhe nëpër stane rrajcarët. Në Pishkash fiset Mekshi Skura, Polisi Bisku, në Skroskë fiset Omeri, Ozuni, Belba hapën dyert dhe strehuan për disa kohë rrajcarët. Një luftë e ashpër u zhvillua me forcat serbe në Malin e Skurës. Në atë luftë morën pjesë edhe luftëtarë nga Rrajca. Gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore 1914-1916 Treva e luginës së këtej Shkumbinit ka derdhur shumë gjak për mbrojtjen e lirisë, qëndroj heroikisht në përballjen

me ushtritë e modernizuara, me armatime të shumta në numër serbo-sllavët kryen masakra çnjerëzore në Rrajcë, Pishkash, Kokreve, Dragostunë, Shkalla e Lunikut e në Prevallë. Kjo traditë e lashtë e kësaj treve filloj mbas mbledhjes që bënë patriotët shqiptarë në Prevezë. Por zhvillim më të madh mori kur dy patriotët të kësaj zone sollën abetaret e para në gjuhën shqipe Hamit Osman Allidri në Rrajcë në vitin 1883 dhe Halit Berzeshta në Berzeshtë. Berzeshta kishte edhe burra të tjerë që u shkolluan në Stamboll si: Shaban Blloshmi, Hajdar Blloshmi, Ali Berzeshta, Selaudin Blloshmi në atë fshat është përkund djepi i atdhetarëve. Në Rrajcën martire mësuesit të parë Hamit Allidrit ju ndërpre aktiviteti për përhapjen dhe për mësimdhënien në gjuhën shqip. Atij ja zbulojnë abetaret dhe konfliktohet me këshilltarin duke e vrarë atë dhe për këtë rast e dënojnë me dënimin kapital. Në vitin 1906 Hamiti me disa patriotë arratiset nga Stambolli dhe sapo erdhi në Rrajcë e fillon aktivitetin e tij për të luftuar përkrah patriotëve të tjerë për shpalljen e pavarësisë. Që nga ajo kohë Hamiti kishte marrëdhënie të mira me patriotët e Berzeshtës, Aqif Pash Elbasanin, Kamer Skurën, Pishkash, Sali Omerin në Skroskë me Riza Hajron në Ladorisht me fisin Dauti e Raman në Ladorisht po ashtu dhe me fisin Murtishi. Me fisin Selimi në Ferngorë, edhe gjatë kohës së Zogut marrëdhëniet me fshatrat Pishkash dhe Skroskë kanë qenë të mira. Nuk kemi asnjë konflikt hasmërie gjatë tërës së kësaj rrjedhe historie në këto treva të lashta e të banuara. Marrëdhënie krushqie me këto fshatra kanë qenë tepër të rralla për arsye të rrobave që mbante Rrajca. Një zhvillim i këtyre marrëdhënieve mori në vitet e diktaturës në kohën kur u ndërtuan rrobat e grave dhe burrave. Në ato vite dhamë dhe morëm shumë nuse si në Pishkash ashtu edhe në Skroskë. Kjo traditë vazhdon edhe në këto vitet e fundit (edhe sot). Me hapjen e minierës së Pishkashit dhe disa sektorëve të tjerë si Guri i Pishkashit, Pishkash Veri dhe Skrosko. Në minierën e Pishkashit punuan shumë djem e burra nga Rrajca të cilët u dalluan në profesionet që mësuan dhe

punuan për disa vite rresht. Nga Rrajca dolën shumë shoferë, ekskavatoristë, sondistë, buldozeristë, mekanikë, minatorë të talentuar e të palodhur. Në minierën e Pishkashit shumica e drejtuesve kanë qenë nga Pishkashit dhe Skroska. Ndër më njerëzorët dhe më të respektuarit unë po përmendi disa nga ata që i kam njohur nga afër dhe i kam patur shef sektori dhe përgjegjës turmi. Baftjar Polisi një burrë fisnik dhe i dashur nga të gjithë ata që e njohën e punuan me të, Ali Omerin, tepër i thjeshtë e njerëzor, Sadik Llojkun një burrë tepër aktiv dhe i dashur me punëtorët, Adem Gulen një njeri i sinqertë e bujar, me plot batuta dhe humor.

Ndër mjeshtrit e talentuar të Rrajcës do përmendi pak se ata janë shumë. Minatorët Aqif Rira, Enver Seiti, Xhevair Çuku, mekaniku Hysni Bozha, ekskavatoristi Refik Rira. Buldozeristi Mehdi Bogdani. Elektriçisti Halit Stojna.

Gjatë këtyre viteve rrajcarët dhe kuadrot e Pishkashit dhe Skroskës patën marrëdhënie të mira.

E shkrova këtë shkrim në respekt të kësaj tradite të lashtë të kësaj treve, me respekt dhe për nderim të atyre burrave trima e patriotë që kontribuan tërë jetën për pavarësi, lirinë e atdheut, për konsolidimin e shtetit shqiptar, duke luftuar krah për krah me vëllezërit shqiptarë kudo dhe kurdoherë. Trevat e luginës së lumit Shkumbin do shkonin vullnetar për të mbrojtur atdheun. Në luftën e Shkodrës Rrajca çon vullnetarët e saj dhe njëri ra në fushën e betejës në luftë kundër malazezëve Saku Elmas Stojna. Edhe Pishkashit e Skroska dërguan vullnetarë në Shkodër, e gjithë treva e Librazhdit çoj në Shkodër vullnetarë.

Edhe në vitin 1920 Rrajca do ishte përkrah patriotit Aqif Pashë Elbasanit dhe dërgoj në Vlorë vullnetarë, po ashtu edhe Pishkashit dërgoj vullnetarë Bërzeshita edhe fshatra të tjerë.

I dashur lexues i brezit të ri ju e ardhmja e kësaj treve është mirë ta dini e ta mësoni historinë e kësaj treve, ta ruani e ta kultivoni traditën e të parëve, dashurinë që ata panë për njëri tjetrin në momente tepër të vështira, besën që dhanë dhe bukën që ndanë mes dhimbjesh dhe lotësh gjatë përleshjeve që bënë me sllavo-serbët e vonë dhe taborët turke më herët. Edhe në kohën tonë duhet ta mbajmë të ndezur prushin e atdhetdashurisë, respektin dhe dashurinë për mikun dhe shokun. Vetëm me harmoni dhe dashuri jeta bëhet më e bukur. Po e mbyll me vargjet e Naimit:

Atje ku është bukuria dhe harmonia, aty shfaqet Perëndia me tërë mirësitë e tij. Uroj që brezi i ri t'i sjellë trevës tonë prosperitetin, zhvillimin, dashurinë, harmoninë. Të vetmet mënyra për të jetuar në liri.